



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRIM
Prilq/Bl. sh. 66
Datë/Datum: 04.04.2019
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE

Datë: 03.04.2019

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.03.2019, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 288, të datës 14.03.2019, paraqitur nga Drejtorja e Financave dhe Buxhetit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c, l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 46, paragrafi 46.2, të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë Nr. 03/L-048, (Gazeta Zyrtare 27/2008), nenin 27, shkronja (ç, nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 25, paragrafi 4, nenin 27, paragrafi 2, të Rregullores për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale Nr. 125, të datës 25.09.2014, mori:

V E N D I M

Për aprovimin e buxhetit të shpenzuar në Komunën e Fushë-Kosovës për vitin 2018

1. Për aprovimin e buxhetit të shpenzuar në Komunën e Fushë-Kosovës, për vitin 2018, në shumë të përgjithshme prej 9,767,699.43€.
2. Buxheti i shpenzuar sipas programeve është si vijon:
 - 2.1 Në administratën komunale, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 4,833,648.58€;
 - 2.2 Në arsim, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 3,504,299.11€;
 - 2.3 Në shëndetësi, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 1,394,930.58€;
 - 2.4 Në Zyrën e Komuniteteve, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 34,821.16€.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtorja e Financave dhe Buxhetit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB dhe Arkivës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DIREKTORIA E ADMINISTRATIVES - DIREKCIJA ZA ADMINISTRATIVES
Nr.faq/Br.st. 67
Date/Datum: 04.04.2019
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE

Datë: 03.04.2019

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.03.2019, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 48, të datës 18.04.2019, paraqitur nga Kryesuesja e Kuvendit të Komunës, bazuar në nenin 11, nenin 40, nenin 61, paragrafi 61.3, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 4, nenin 6, paragrafi 1 dhe 2, të Udhëzimit Administrativ Nr. 2014/01, për procedurat e emërimit të Nënkyetarëve në Komunë, nenin 27, të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për emërimin e z. Qerim Gara në pozitën e Nënkyetarit të Komunës për Komunitete

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 398, të datës 18.03.2019 për emërimin e z. Qerim Gara i lindur më datë 15.02.1953 me vendbanim në Fushë-Kosovë, me profesion murator, përfaqësues nga subjekti politik Partia Demokratike e Ashkalinjëve të Kosovës, në pozitën e Nënkyetarit të Komunës për Komunitete në Komunën e Fushë-Kosovës në mandatin zgjedhor 2017-2021.
2. I emëruari në pozitën e Nënkyetarit të Komunës për Komunitete në Komunën e Fushë-Kosovës, të drejtat dhe përgjegjësitë e tij do të fillon t'i ushtron nga dita e emërimit të tij nga data 28.03.2019, konform dispozitave ligjore në fuqi.
3. Nënkyetari i Komunës për Komunitete për punën e tij i përgjigjet Kuvendit të Komunës.
4. Kryerja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit, Udhëheqëses së Personelit, konform Udhëzimit Administrativ Nr. 16/2008 për pagesën e stafit politikë në komunë, të Qeverisë së Kosovës.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës,
Nënkyetarit të Komunës për Komunitete, Drejtorisë së FB, Udhëheqëses të
Personelit dhe Arkivës.**

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
ORGANIZIMI I ADMINISTRATIVES - ORGANIZACIJA ZA ADMINISTRACIJU
Nr.faq/Nr.sti: 68
Datë/Datum: 04.04.2019
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE

Datë: 03.04.2019

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.03.2019, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 48, të datës 18.04.2019, paraqitur nga Kryesuesja e Kuvendit të Komunës, bazuar në nenin 11, nenin 40, nenin 54, paragrafi 54.1, paragrafi 54.2, nenin 55 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, nenin 29, paragrafi 29.3 të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për emërimin e z. Bashkim Krasniqi në pozitën e Zëvendës Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për Komunitete

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 48, të datës 18.04.2019 për emërimin e z. Bashkim Krasniqi i lindur më datë 03.04.1980 me vendbanim në Fushë-Kosovë, përfaqësues nga subjekti politik Partia Liberale Egjiptiane, në pozitën e Zëvendës Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për Komunitete në Komunën e Fushë-Kosovës për mandatin zgjedhor 2017-2021.
2. I emëruari në pozitën e Zëvendës Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për Komunitete në Komunën e Fushë-Kosovës, të drejtat dhe përgjegjësitë e tij do të fillon t'i ushtron nga dita e emërimit të tij nga data 28.03.2019, konform dispozitave ligjore në fuqi.
3. Zëvendës Kryesuesi i Kuvendit të Komunës për Komunitete për punën e tij i përgjigjet Kuvendit të Komunës.
4. Kryerja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit, Udhëheqëses të Personelit, konform Udhëzimit Administrativ Nr. 16/2008 për pagesën e stafit politikë në komuna, të Qeverisë së Kosovës.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Zëvendës Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për Komunitete, Drejtorisë së FB, Udhëheqëses të Personelit dhe Arkivës.

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha**






REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 03.04.2019



Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.03.2019, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 102, të datës 13.03.2019, paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit Urban, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (g, l), nenin 68, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 22, të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110, (Gazeta Zyrtare Nr. 18/2012), nenin 27, shkronja (f, nj), nenin 54, shkronja (dh, f) të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin në parim të Propozimit Nr. 102, të datës 13.03.2019, për caktimin e taksës administrative për leje të ndërtimit, tarifës rregullative për rritjen e densitetit në infrastrukturë, taksës për leje të rrënimin për vitin 2019

1. Për aprovimin në parim dhe dërgimin në procedurën e diskutimit publik të 'Propozimit për caktimin e taksave administrative për vitin 2019, për lëshimin e lejeve ndërtimore, në shumë prej 1.51€ për një metër katror në kategorinë e parë dhe për kategorinë e dytë në shumë prej 1.96€ për një metër katror'.
 2. Për aprovimin në parim dhe dërgimin në procedurën e diskutimit publik të 'Propozimit për caktimin e tarifës rregullative për rritjen e densitetit në infrastrukturë për vitin 2019, për lëshimin e lejeve ndërtimore në shumë prej 4.75€ për një metër katror'.
 3. Për aprovimin në parim dhe dërgimin në procedurën e diskutimit publik të 'Propozimit për caktimin e taksës për leje të rrënimin për vitin 2019, në shumë prej 0.89€ për një metër katror'.
 4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera, për zbatimin e vendimit, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Planifikimit Urban.
 5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.
- Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së PU dhe Arkivës.**


Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 03.04.2019

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.03.2019, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 302, të datës 18.03.2019, paraqitur nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, në lidhje me kërkesën Nr. 02-070/02-0007136/19, të datës 21.02.2019 nga pala Xhevdet Qiriqi, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (ç), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 41, paragrafi 16, nenin 43, paragrafi 7, të Rregullores për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale Nr. 125, të datës 25.09.2014, nenin 13, paragrafi 3, të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr. 83, të datës 14.06.2013, mori:

V E N D I M

Për aprovimin e propozimit për lejimin e mjeteve financiare për shërim


1. Për aprovimin e propozimit për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej 9,000.00€, për shërim shëndetësorë jashtë vendit, për palën Xhevdet Qiriqi nga fshati Sllatinë e Madhe, i cili vuan nga sëmundja me diagnozë: St. post vulnus scloetra regio cubiti sin.
2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për sigurimin e mjeteve financiare, për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit dhe Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorisë së SHMS, Palës dhe Arkivës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës


Vjollca Konjusha





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 03.04.2019

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.03.2019, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 300, të datës 18.03.2019, paraqitur nga Drejtoria e Arsimit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (ç), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 48, paragrafi 12, të Rregullores për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale Nr. 125, të datës 25.09.2014, mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Propozimit Nr. 300, të datës 18.03.2019 për dhënien e pëlqimit për realizimin e funksionimit të Çerdhes së Fëmijëve në fshatin Miradi e Poshtme


1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 300, të datës 18.03.2019 për dhënien e pëlqimit për realizimin e funksionimit të Çerdhes së Fëmijëve në fshatin Miradi e Poshtme, në bashkëpunim me investitorin Shoqatën për Edukim 'Childproof', e cila do të investon shumë e mjeteve financiare prej 40,000.00€ për renovimin e objektit publik.
2. Funksionalizimi i objektit publik, Çerdhes së Fëmijëve në fshatin Miradi e Poshtme, do të realizohet në përputhje me dispozitat e legjislacionit dhe arritjes së marrëveshjes së bashkëpunimit me Organizatën Lokale 'Cipof', për renovimin dhe zgjerimin e hapësirës së objektit për edukimin parashkollor të fëmijëve nga 0-6 vjeç në këtë fshat, për fëmijët e fshatrave të rrethinës.
3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Arsimit, në funksion të aktivizimit të objektit ekzistues.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së ARSIMIT, Palës dhe Arkivës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 03.04.2019

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.03.2019, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008) dhe nenin 27, shkronja (ç) të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për lejimin e vizitës zyrtare të anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës në Republikën e Shqipërisë

1. Për lejimin e vizitës zyrtare të anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, në Republikën e Shqipërisë.
2. Sigurimi i mjeteve financiare për realizimin e vizitës zyrtare dhe kryerja e procedurave tjera, për zbatimin e vendimit, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB dhe Arkivës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha

